



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr. 130/01-7036

Datë 21.03.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 40 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 03/L-0149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe neni 12 dhe 14 të Rregullores nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. znj. Besjana Shyti, e sistemuar në detyrat e punës si Referente Administrative në Zyrën e Pranimit në Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative, i lejohet shfrytëzimi i pushimit prindëror (të lehonisë) nga datë 06.03.2018 me kompensim si në vijim:

1.1. Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga Komuna e Gjakovës me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunëses;

1.2. Tre (3) muajt në vijim, paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë;

1.3. Tre (3) muaj e tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunëses civile.

2. Pas përfundimit të pushimit të lehonisë, nëpunësja kthehet në pozitën e mëparshme;
3. Në rast të ndërprerjes së pushimit të lehonisë nga ana e nëpunëses, njoftimi për ndërprerje bëhet pesëmbëdhjetë (15) ditë para;
4. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A R S Y E T I M

Pas pranimit të Flete lëshimit me numër 336 dhe Certifikatës së Lindjes me 20.03.2018, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 40 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 03/L-0149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe neni 12 dhe 14 të Rregullores nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, është cilësuar se nëpunësja znj. Besjana Shyti ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë sipas afate të përcaktuara me Rregullore, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit e të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

Vendimi t'iu dorëzohet: znj. Besjana Shyti, Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa - Shërbimit të Pagesave, Zyrës së Personelit dhe Arkivit.



Kryetari i Komunës së Gjakovës